Studio Ligjore HAKANI & ASSOCIATES
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
NUIS: L61403057A
Rruga "Vaso Pasha", Pallati 13/1, Kati i Zyrave, Nr.3, Tiranë.

---

# VENDIM 1 (2018)

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
(Ortakut të Vetëm)

Sot, më datë 19.01.2018 në selinë e shoqërisë u mblodh asambleja e përgjithshme e shoqërisë "Studio Ligjore HAKANI & Associates" sh.p.k, me NUIS L61403057A me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm Arben A. HAKANI, zotërues i 100% të kuotave të kapitalit, me rend dite:

- Rikonfirmimi për efekt publikimi, i marrjes përsipër i të gjithë të drejtave dhe detyrimeve të "Studio Ligjore HAKANI & Associates", deri ne Janar 2016 me status person fizik avokat arben a. Hakani, nga shoqëria "Studio Ligjore HAKANI & Associates" shpk, me ortak dhe administrator po me avokat arben a. Hakani.

- Të shihet mundësia që të merret (regjistrohet) në evidencën kontabël në aktivet e shoqërisë A.A.M, pasuria e paluajtëshme e llojit "apartament" me sip.132.6 m2, me nr.pasurie 3/106+1-6, ZK.8270 ndodhur në Rrugën 356, apartamenti F sipas të dhënave të regjistrimit, ose Rruga "Vaso Pasha", Pall.13/1, Kati i Zyrave Nr.3, Tiranë regjistruar në Vol.43, Faqe 138, në bashkëpronësi me ½ pjesë secili, të ortakut Arben Agim Hakani dhe bashkëshortes Mimoza Islam Hakani, kjo sipas çertifikatës së pronësisë datë 20.10.2016 të ZVRPP Tiranë, duke e regjistruar në aktivet e shoqërisë.
- Te ndryshme.

Drejtuesi i mbledhjes që është ortaku i vetëm i shoqërisë, njëherësh administrator , parashtroi se:

1. Nga Janari i vitit 2016, studioja ndryshoi statusin juridik, nga person fizik në person Juridik i llojit shpk me ortak dhe administrator po avokatin arben a HAKANI. Pavarsisht se personi fizik avokati Arben A. Hakani, ndërpreu (pezulloi) juridikisht aktivitetin për arsye se ligji tregtar nuk lejon bashkim me përthithje të personave fizik tek personat juridik, faktikisht të gjithë të drejtat dhe detyrimit që kishte si person fizik juridikisht u vazhduan dhe kaluan tek shoqëria po e tij. Ky fakt shihet kt e shohim Për këtë arsye paraqet vendimi i Shoqërisë i Shkurtit 2016, me objekt vazhdimsia e të gjithë të drejtave dhe detyrimeve të personit fizik tek shoqëria, vendim që behet pjesë për efekt publikimi në QKB.
2. Nisur nga fakti se pasuria e paluajtshme e sipërcituar përdoret aktualisht për ushtrimin e veprimtarisë, seli ligjore e shoqërisë "Studio Ligjore HAKANI & ASSOCIATES" shpk, pra është në posedimin efektiv të saj, në zbatim të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.1, pikat 17,18,79 dhe 80, i miratuar me Vendimin Nr.1 datë 25.06.2014 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të shpallur për zbatim me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.64 datë 22.07.2014, nenit 4 te ligjit nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe ligjit 8438 date 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" Neni 22, pika 1, gërma b), me vullnetin ortakut të vetëm njiherësh bashkëpronar dhe pëlqimin me shkrim nga bashkëshortja Mimoza Hakani me deklaratë datë 19.12.2018, kjo pasuri lejohet të regjistrohet edhe në Aktivet Afatgjatë e kësaj shoqëre.

Nga sa mësipër, ortaku
VENDOS;

- Rikonformimi i të gjithë të drejtave dhe detyrimeve që ka patur "Studio Ligjore HAKANI & Associates" e përfaqsuar nga avokat arben a Hakani me status person fizik, nga shoqëria "Studio Ligjore HAKANI & Associates" shpk, me ortak dhe administrator, arben a. Hakani,.

- Të merret në evidencën kontabël, duke e rregjistruar në aktivet e shoqërisë A.A.M, pasuria e paluajtshme e llojit "apartament" me sip.132.6 m2, me nr.pasurie 3/106+1-6, ZK.8270 ndodhur në Rrugën 356, apartamenti F sipas të dhënave të regjistrimit, ose Rr."Vaso Pasha", Pall.13/1, Kati i Zyrave Nr.3, Tiranë regjistruar në Vol.43, Faqe 138 në bashkëpronësi të ortakut Arben Agim Hakani dhe bashkeshortes së tij Mimoza Islam Hakani me ½ pjesë, sipas çertifikatës së pronësisë datë 20.10.2016 të ZVRPP Tiranë.

- Pasuria të regjistrohet me vlerën 21 688 056 lekë lekë që është vlera e përcaktuar dhe në regjistrat publike te ZVRPP Tiranë.
- Ky vendim ka fuqi prapavepruese për pikën e parë, dhe hyn në fuqi menjëherë.

Bashkëlidhur deklarata datë 19.01.2018 për dhënien e pëlqimit nga bashkëpronarja Mimoza Hakani, çertifikata e pronësisë e viti 2016.

Ortaku Vetëm
Arben A.HAKANI

HAKANI & ASSOCIATES
Dhoma e Avokatise Tiranë
NUIS: L51400357A
Tel: +355 4 22 40230
email: hakani@hakani-attorneys.al